



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Himarë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**Lënda:** Kthim përgjigjeje shkresës së datës 13.02.2024, me lëndë : “Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit ose regjistrimit audio”.

Bazuar në kërkesën suaj të datës 13.02.2024, me lëndë : “Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit ose regjistrimit audio”, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.865 prot., më datë 15.02.2024, po ju informojmë si më poshtë vijon:

Projekti “RWS-III- Projekti i furnizimit me ujë për fshatrat Kuc, Kudhës, Pilur – Himarë – Loti 3.2”, është pjesë integrale e projektit madhor “Programi i Furnimit me Ujë Rural III” me financues Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW), Bashkimin Evropian përmes IPA si dhe Qeverinë Shqiptare. Në këtë kuadër me financim nga WBIF, gjatë periudhës nëntor 2015 – maj 2016, u hartuan fizibilitetet teknike dhe sociale.Në fund të këtij procesi janë administruar 252 aplikime nga 59 bashki. Përgatitja e fizibiliteteve teknike, sociale dhe mjedisore ka përfunduar për 30 skema, nga të cilat 19 prej tyre kanë rezultuar fizibël. Banka Gjermane për Zhvillim - KfW ka dhënë miratimin për 18 skemat e para ku Bashkia Himarë ka qenë një nga përfituesit.

Më datë 29.01.2019 ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit (në rolin e autoritetit kontraktor) dhe Bashkisë Himarë (në rolin e përfituesit) është nënshkruar marrëveshja për investim për realizimin e objektit “RWS-III- Projekti i furnizimit me ujë për fshatrat Kuc, Kudhës, Pilur – Himarë – Loti 3.2”.

Referuar kërkesës suaj, për informacion të dokumentuar në lidhje me konsultimet publike të zhvilluara në lidhje me këtë projekt, ju sqarojmë se bazuar edhe në parashikimet e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, është organi i cili krijon projektaktin ai i cili ka detyrimin ligjor për publikimin e projektaktit, të njoftimit për konsultim dhe të administrimit të të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve. Për këtë arsye, bashkëlidhur kësaj shkrese po ju dërgojmë disa nga dokumentacionet me anë të të cilave na janë njoftur zhvillimi i konsultimeve publike apo na janë dërguar pas zhvillimit të konsultimeve, të dërguara me postë elektronike. Sqarojmë se, duke qenë se procesverbalet nuk janë hartuar nga ne, nuk mbajnë vulë të institucionit tonë.

**Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!**

**KRYETARI I BASHKISË**

**Jorgo Goro**